



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI KONTRAKTOR**  
**BASHKIA BULQIZE**

Adresa : Lagjia Minatori Bulqize, Albania

email.bashkia.bulqize@bulqize.gov.al

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Bulqizë, më \_\_\_\_/04/2021

Per: ALB-KON, Adresa: Diber Bulqize BULQIZE Lagjia e Re, me NIPT: K06626411C

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për propozim.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-87020-02-15-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Ndërtim Trotuarit në rrugën kryesore dhe Ndërtimi i murit të Pazarit në Shupenzë.: Kohëzgjatja, 1 muaj.**

Publikime të mëparshme, (nuk ka):

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 26 datë 22 Shkurt 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

oferta ekonomikisht më e favorshme

Hapja ofertave u bë me: **01.03.2021**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **ALB-KON**, me NIPT: K06626411C

Vlera: 10 564 218 (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë ) lekë PA TVSH

2. **EGLAND**, me NIPT: J96829419D

Vlera: 10 662 531 (dhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e një ) lekë PA TVSH.

3. **K.TURJA**, me NIPT: K81314014A

Vlera: 8 361 470 (tetë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë PA TVSH.

4. **NIKA**: me NIPT: J76705047U

Vlera: 7 745 140 (shtatë milion e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e dyzet) lekë PA TVSH

5. 2 N. me NIPT: L31615017L

Vlera: 8 002 165 (tetë milion e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë PA TVSH

Janë kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **ALB-KON**, me NIPT: K06626411C

Vlera: 10 564 218 (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë ) lekë PA TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **EGLAND**, me NIPT: J96829419D

Vlera: 10 662 531 (dhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tridhjetë e një ) lekë PA TVSH.

2. **K.TURJA**, me NIPT: K81314014A

Vlera: 8 361 470 (tetë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë PA TVSH.

3.**NIKA**: me NIPT: J76705047U

Vlera: 7 745 140 (shtatë milion e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e dyzet) lekë PA TVSH

4. 2 N. me NIPT: L31615017L

Vlera: 8 002 165 (tetë milion e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë PA TVSH

Përkatësisht per arsyet e mëposhtme:

## **EGLAND**

Nga ana e Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë, deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1; Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1: Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6; Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7; Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 ;Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10;

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratat e mësipërme.

Nga na e Autoritetit Kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik Për kapacitetin teknik:

1.Përsa I përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si mëposhtë:

### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet , të realizuar gjatë tre viteve te fundit;

ose

b. Kontrata të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi I vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi I njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën e kualifikueshme.

Vlerësimi I përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Deklaratë sipas shtojces nr 8 shoqëruar me :

- Kontrata
- Situacioni perfundimtare
- Aktin e kolaudimit
- Aktin e marrjes ne dorëzim.

Në rastin e përvojës së mëparshme në sektroin privat kërkohen të paraqiten:

- Kontrata
- Aktin e kolaudimit Situacionin perfundimtar.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur si punë të ngjashme kontratën me Nr. 2668 prot, datë 19.06.2020 lidhur me Bashkinë Bulqizë operatori ekonomik nuk ka paraqitur aktin e marrjes në dorëzim.

Nga ana e Autoriteti Kontraktor është kërkuar në dokumentat e tenderit që Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik si më poshtë:

Karponentier 2(dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, iqt (ejkuivalente), dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Shofer kamioni 1 (një) Shofer kamioni te punësuar , për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, IQT (ejkuivalente), leje drejtimi mjete të lëshuar nga organet kompetente. dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Manovrator 2 të punësuar, për këtë duhet të paraqesë, kontratë punë të vlefshme, IQT (ejkuivalente), leje drejtimi mjete të lëshuar nga organet kompetente. dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Murator 2(dy) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, iqt (ejkuivalente), dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Pllaka Shtrues 3(tre) për këtë duhet të paraqesë, kontrate pune të vlefshme, iqt (ejkuivalente), dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Mekanik 1(një) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, iqt (ejkuivalente), dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e ne vazhdim.

Elektracist 1(një) për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, iqt (ejkuivalente), dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për stafin e mësipërm.

Nga ana e Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar Një punësim mesatar i të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) personave, punonjës të siguruar.

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve të figurojnë në listpagesën e muajit Dhjetor 2020 e në vazhdim, nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për plotesimin e këtij kriteri.

Nga ana e Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

#### **Nr LLOJI I MAKINERIVE PRONESIA**

##### **SASIA Minimumi**

- Kamiona me kapacitet mbi 16 ton Ne pronësi ose me qera 1 cope
- Kamioncine mbi 3 ton Ne pronësi ose me qera 2 Cope
- Eskavator me goma Ne pronësi ose me qera 1 Cope
- Motogjenerator Ne pronësi ose me qera 1 cope
- Vibrator Betoni Ne pronësi ose me qera 1 cope
- Motobetoniere 0.5 m3 Ne pronësi ose me qera 2 cope
- Fadrome me goma Ne pronësi ose me qera 1 cope
- Rul vibrues deri ne 1 ton Ne pronësi ose me qera 1 cope
- Autobot Ne pronësi ose me qera 1 cope
- Makineri per skarifikim asfalti Ne pronësi ose me qera 1 cope
- Autovinç Ne pronësi ose me qera 1 cope

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetet e mësipërme

a) Nga ana e autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit eshte kerkuar qe operatori ekonomik te kete ne Pronësi ose me qera linje prodhimi inertesh,ose kontrata furnizimi nga nje subject i licensuar dhe me leje mjedisore per prodhimin e inerteve.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion per plotesimin e ketij kriteri.

#### **K.TURJA**

Nga verifikimi dokumentacionit të shoqërisë K.Turja Shpk rezultoi se nga ana e Autoritetit Kontraktor në Dokumentat e tenderit është kërkuar Vërtetim lëshuar nga Bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për dy vitet 2019-2020 sipas vendushtrimit të aktivitetit. Nga verifikimi i dokumentacionit të shoqërisë K.Turja shpk për periudhën 2019 , 2020 shoqëria ka pasur adresa dytësore në Bashkinë Krujë, Bashkinë Tiranë, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave për vitin 2019, 2020 nga Bashkia Tiranë.

Nga ana e Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që Për kapacitetin teknik:

1.Përsa I përket aftësisë teknike e profesionale,Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kerkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si mëposhtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet lekë pa T.V.SH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit;

ose

b. Kontrata të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi I vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi I njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën e kualifikueshme.

Vlerësimi I përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Deklaratë sipas shtojces Nr.8 shoqëruar me :

- Kontrata
- Situacioni perfundimtare
- Aktin e kolaudimit
- Aktin e marrjes ne dorezim.

Në rastin e përvojës së mëparshme në sektroin privat kërkohen të paraqiten:

- Kontrata
- Aktin e kolaudimit Situacionin perfundimtar.

Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezultoi se ka paraqitur si punë të ngjashme kontratën Nr.29912/6 datë 26.09.2018 lidhur me Bashkinë Tiranë , operatori ekonomik nuk ka paraqitur aktin e marrjes në dorëzim.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar teknik ndertimi 1 (një) për këtë duhet të paraqesë Diplomë të shkollës së mesme, kontratë pune të vlefshme , IQT (ejkuivalente) dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim, nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion si teknik ndertimi për Znj.Zamira Turja operatori ekonomik nuk ka paraqitur diplomë të shkollës së mesme për Znj.Zamira Turja.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor është kërkuar në dokumentat e tenderit që operatori ekonomik të ketë të punësuar Shofer kamioni 1 (një) Shofer kamioni të punësuar, për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, IQT (ejkuivalente), leje drejtimi mjete të lëshuar nga organet kompetente. dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur IQT për asnjë punonjës Shofer Kamioni.

## **NIKA**

Nga verifikimi dokumentacionit të shoqërisë Nika Shpk rezultoi se nga ana e Autoriteti Kontraktor në Dokumentat e tenderit është kërkuar Vërtetim lëshuar nga Bashkia për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për dy vitet 2019-2020 sipas vendushtrimit të aktivitetit. Nga verifikimi i dokumentacionit të shoqërisë Nika shpk rezultoi se për periudhën 2019 , 2020 shoqëria ka pasur adresa dytësore në Bashkinë Shkodër, Bashkinë Lezhë, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Gjirokastrë, Bashkinë Korçë dhe Bashkinë Tiranë. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim

për shlyerjen e takasave për vitin 2019, 2020 nga Bashkia Lezhë, operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave nga Bashkia Vlorë ka paraqitur një vërtetim nga njësi administrative Selenicë, njësi administrative nuk është organi kompetent për mbledhjen dhe administrimit të taksave vendore kjo në referim të ligjit nr 9920 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave për vitin 2019, 2020 nga Bashkia Gjirokastrë.

Nga ana e Autoriteti Kontraktor është kërkuar në dokumentat e tenderit që operatori ekonomik të ketë të punësuar teknik ndërtimi 1 (një) për këtë duhet të paraqesë Diplomë të shkollës së mesme, kontratë pune të vlefshme , IQT (ejkuivalente) dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim.

Nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se ka paraqitur dokumentacion për teknik ndërtimi për Z Edmond Manoku nga ana e operatorit ekonomik nuk është paraqitur diplomë e shkollës së mesme për profil teknik ndërtimit.

Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të ketë të punësuar Shofer kamioni 1 (një) Shofer kamioni të punësuar , për këtë duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, IQT (ejkuivalente), leje drejtimi mjeti të lëshuar nga organet kompetente. dhe të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaji Dhjetor 2020 e në vazhdim. Nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion si shofer për Z .Benet Ndoci dhe Z Edmond Nika IQT e paraqitur për këto persona janë lëshuar nga nga HVAT nga verifikimi në DPA nuk është akredituar për certifikim të profesionit shofer.

Nga ana e Autoriteti Kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik duhet të disponojë një eskavator me goma në pronësi ose me qera ,Nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion si eskavator me goma për mjetin me targa KO4907B marrë me qera nga Ervin Hasani nga verifikimi I dokumentacionit rezulton se mjeti është fadromë me goma dhe jo eskavator.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik duhet të disponoj një autobot uji në pronësi ose me qera. Nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur si Autobot uji mjetin me targa AA 301 VR nga verifikimi I lejes së transportit rezultoi se leja e transportit për këtë mjet është lëshuar në emër të shoqërisë Borshi shpk për përdorim të vetë si i tillë nuk mund të jepet me qera .

Nga ana e Autoriteti Kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik duhet të disponojë një eskavator me autovinc ose me qera Nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur si autovinç mjetin me targa AA 762 KI nga verifikimi I lejes së transportit rezultoi se leja e transportit për këtë mjet është lëshuar në emër Z.Joni SENA për përdorim të vetë si i tillë nuk mund të jepet me qera.

Pronësi ose me qera linjë prodhimi inertesh,ose kontrata furnizimi nga një subjekt i licensuar dhe me leje mjedisore për prodhimin e inerteve

Nga verifikimi I dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik ka paraqitur një kontratë qëraje të nënshkruar me datë 19.05.2019 të lidhur me shoqërinë Alba beton shpk me objekt marrje me qera IMPIANT BETONI, MODEL COMES SPECIAL 4 dhe I(TYJE INERTESH, kontrata është shoqëruar me leje mjedisore e cila figuron të jetë në emër të shoqërisë ALBA Beton referuar legjislacionit në fuqi leja mjedisore nuk mund të transferohet nëpërmjet kontrates së qirasë pa miratim të organit administrativ kompetent sa më sipër duke qenë se mjetet janë marrë me qera dhe nuk jemi perpara kontratës së furnizimit shoqëria Nika shpk duhet të jetë i paisur me leje mjedisore për prodhimin e inerteve.

Nga Autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë Vertetim nga tatim taksat për xhiron e tre viteve të fundit 2017-2018-2019 në një vlerë mesatare sa e fondit limit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron për periudhën e kërkuar.

Nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet si Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës, të ketë në pronësi ose me qera jo më pak se një eskavator me goma. Nga ana e operatorit ekonomik nuk është paraqitur dokumentacion për një mjet të tillë.

Nga ana e operatorit ekonomik në deklaratën nr 9 mbi MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE ka deklaruar një mjet eskavator me goma marrë me qera me të dhenat e mëposhtme Eskavator me goma Nr.Rep. 2496 Nr.Kol. 432 15/12/2020- 14/12/2025 nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se nuk ka paraqitur dokumentacion si (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, si dhe lejen e transportit nga institucionet përkatës për një mjet të tillë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se oferta e paraqitur nga **ALB-KON me NIPT: K06626411C** dhe me Adresë Diber Bulqize BULQIZE Lagjja e Re , me një vlerë të përgjithshme 10 564 218 (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë ) lekë PA TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni në *Bashkinë Bulqizë pranë zyrës juridike* për sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e këtij publikimi por në çdo rast subjekti është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës në zbatim të nenit 21 të Vkm 914, datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, Proçedura do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Ankesa: Nr. 1330 datë 24.03.2021

Marrë përgjigje: 30.03.2021

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **16/03/2021**

Data e publikimit të këtij njoftimi: **12/04/2021**

**ZYRTARI I AUTORIZUAR**  
**ENKELEDA LLESHI**